



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilaški Savet Kosova/ Kosovo Prosecutorial**  
**Council**

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 4 Paragrafi 1.25 të Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 83 publikuar me dt. 29 tetor 2010) dhe të nenit 2 paragrafi 1.33, të Ligji Nr. 05/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 17 publikuar me 30 qershor 2015, në takimin e mbajtur me, 27 maj 2016, miraton:

**RREGULLORE NR.06/2016**

**PËR KOMUNIKIM PUBLIK**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është rregullimi i menyrës së komunikimit publik për aktivitetet dhe punën e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Prokurorit të Shtetit.

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

1. Kjo Rregullore zbatohet nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, Prokurori i Shtetit dhe administrata përkatëse e këtyre institucioneve.
2. Kjo Rregullore përcakton komunikimin publik, përgjegjësitë për planifikimin dhe zhvillimin e fushatave të komunikimit publik dhe komunikimin e përgjithshëm të politikave dhe të aktiviteteve të sistemit prokurorial të Kosovës.

**Neni 3**  
**Përkufizimet**

Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:

"KPK" ..... Këshilli Prokurorial i Kosovës.

- “PSH” Prokurori i Shtetit  
“ZKPSH” ... Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit.  
“KPSH” ..... Kryeprokurori i Shtetit.  
“SHC” ..... Shoqëria Civile.  
“OJQ” ..... Organizatë Jo-Qeveritare.  
“MEDIA” .....Të gjitha nivelet dhe format private, publike dhe në internet të komunikimit nëpërmjet shtypit, televizionit, radios dhe/ose shërbimeve të internetit.

#### **Neni 4 Parimet të komunikimit**

Parimet e përgjithshme të komunikimit janë:

- 4.1. Parimi i transparencës;
- 4.2. Parimi i objektivitetit dhe saktësisë;
- 4.3. Parimi i disponueshmërisë së informacionit në kohë të arsyeshme;
- 4.4. Parimi prezumimi i pafajsisë;
- 4.5. Parimi i privatësisë;
- 4.6. Parimi i lirisë së shprehjes dhe shtypit;
- 4.7. Parimi i barazisë;
- 4.8. e drejta për informim,
- 4.9. e drejta për jete private dhe dinjitet si dhe konfidencialiteti i hetimeve,

#### **Neni 5 Objektivat e komunikimit**

1. Lehtësimi i komunikimit në mes të sistemi prokurorial dhe publikut;
2. Të fuqizoj bashkëpunimin në mes të sistemit prokurorial dhe publikut;
3. Të rrisë vetëdijësimin e publikut lidhur me rolin, përgjegjësitë dhe veprimtaritë përkatëse të sistemit prokurorial;
4. Të promovojë pjesëmarrjen e publikut në parandalimin e krimit dhe në procesin e reformave në sistemin prokurorial, dhe
5. Të promovojë llogaridhënien publike të sistemit prokurorial, duke ruajtur integritetin, pavarësinë dhe paanshmërinë.

## **Neni 6**

### **Balancimi i Interesave**

1. KPK dhe PSH sigurojnë qasje në informacion për publikun lidhur me veprimtarinë e sistemit prokurorial.
2. Qasja e publikut në informacion balancohet me përgjegjësinë dhe kompetencat e sistemit prokurorial por gjithmonë në shërbim të mbrojtjes së sigurisë publike.
3. KPK dhe PSH vëmendje të veçantë i kushtojnë mbrojtjes së jetës dhe sigurisë së viktimave, informatorëve, dëshmitarëve, si dhe të drejtës të privatësisë.

## **Neni 7**

### **Zyra për Komunikim Publik në KPK**

1. Zyra për Komunikim Publik në KPK është pikë e kontaktit për publikun dhe burim qëndror i informacionit për KPK-në, përkitazi me veprimtarinë e KPK-së.
2. Zyra për Komunikim Publik në KPK veprimtarinë e saj në raport me publikun e ushtron në koordinim të plotë me Kryesuesin e KPK-së dhe Drejtorin e Sekretariatit të KPK-së.
3. Zyra për Komunikim Publik në KPK ka Menaxherin dhe zyrtarët për komunikim me media.

## **Neni 8**

### **Zyra për Komunikim Publik në ZKPSH**

1. Zyra për Komunikim Publik është pikë e kontaktit për publikun dhe burim qëndror i informacionit për ZKPSH dhe prokuroritë e Kosovës, përkitazi me veprimtarinë e PSH-së.
2. Zyra për Komunikim Publik në ZKPSH veprimtarinë e saj në raport me publikun e ushtron në koordinim të plotë me Kryeprokurorin e Shtetit.
3. Zyra për Komunikim Publik ka Menaxherin dhe zyrtarët për komunikim me media.

## **Neni 9**

### **Zyrtarët për komunikim publik nëpër prokuroritë e Kosovës**

1. Prokuroritë themelore, Prokuroria e Apelit dhe Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës do të kenë zyrtar për komunikim me publikun.
2. Zyrtarët për komunikim publik veprimtarinë e tyre në raport me publikun e ushtrojnë në koordinim me Kryeprokurorin e prokurorisë përkatëse, me prokurorin përkatës të çështjes dhe me Zyrën për Komunikim Publik në ZKPSH.
3. Përveç zyrtarëve për komunikim publik, të cilët janë të obliguar të komunikojnë me publikun, këtë obligim e kanë edhe prokurorët e shtetit në rastet kur kërkojnë përgjigje mediat dhe dhënia e atyre përgjigjeve nuk pengon një proces hetimor.

## **Neni 10**

### **Metodat e komunikimit**

1. Sistemi prokurorial në Republikën e Kosovës përdorë metodat e komunikimit si më poshtë:
  - 1.1 Komunikata për media;
  - 1.2 Paketa informative mediale me pasqyra faktesh dhe grafikone;
  - 1.3 Intervista në media;
  - 1.4 Konferenca shtypi të përqendruara në çështjet me rëndësi publike;
  - 1.5 Diskutime në tavolinë të rrumbullakët me përfaqësuesit e medias;
  - 1.6 Publikime në faqet zyrtare të internetit;
  - 1.7 DVD dhe forma të tjera dixhitale të komunikimit;
  - 1.8 Broshura shpjeguese dhe literaturë tjetër të shtypur;
  - 1.9 Artikuj dhe blogje;
  - 1.10 Ngjarje të veçanta me media, dhe
  - 1.11 Fushata për ndërgjegjësimin e publikut.
2. KPK dhe Prokurori i Shtetit vendosin për përdorimin e metodës së caktuar të komunikimit, varërisht nga rrethanat e rastit.

## **Neni 11**

### **Përgjegjësitë lidhur me komunikimin publik**

1. KPK dhe PSH kanë obligim që të ofrojnë informacion në kohë, në lidhje me çështjet që janë me interes për publikun.

2. Kryeprokurori i prokurorisë përkatëse, prokurori i çështjes, administratori, apo cilado zyre kompetente nga administrata e prokurorive apo KPK-së janë të obliguar që të bashkëpunojnë ngushtë dhe në afatin sa më të shkurtër kohor t'i ofrojnë të gjitha informatat që mund të bëhen publike pranë Zyrave për komunikim publik apo zyrtarit për komunikim me publikun të prokurorisë përkatëse.
3. Zyrat për Komunikim Publik dhe zyrtarët për media të prokurorive themelore, Prokurorisë së Apelit dhe Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës janë të obliguar që në pajtim me ligjet në fuqi, të përgjigjen në pyetjet e medieeve dhe personave të tjerë të interesuar që kanë të bëjnë me një ngjarje aktuale.
4. Zyrat për Komunikim Publik dhe zyrtarët për media të prokurorive, janë të obliguar që në pajtim me ligjet në fuqi, të përgjigjen në pyetjen e medieeve dhe personave të tjerë të interesuar dhe që ka të bëjë për ndonjë temë të ndonjë procesi që ka filluar, është duke u zhvilluar apo ka përfunduar në tërë sistemin prokurorial.
5. KPK dhe PSH, drejteperdrejte apo permes zyrave për Komunikim Publik reagojnë kur në media apo diku tjetër plasohet një informacion i pa drejtë, subjektiv, i njëanshëm, tendencioz etj., që mund të dëmtojë interesin e përgjithshëm të sistemit prokurorial, integritetin profesional dhe moral të prokurorëve të shtetit apo anëtarëve të KPK-së.

## **Neni 12**

### **Kufizimet për dhënien e informatave**

1. Zyrat për Komunikim Publik dhe zyrtarët për komunikim me publikun mund të rezervohen nga dhënia e informacioneve lidhur me ndonjë çështje, nëse për një gjë të tillë ka bazë ligjore apo duhet të ruhet konfidencialiteti për ndonjë proces hetimor të hapur me qëllim të mos cenohet rezultati i ndjekjes penale.
2. KPK, ZKPSH dhe prokuroritë mund të vendosin nëse për dhënien e informacionit ka përparësi interesi publik.
3. KPK, ZKPSH dhe prokuroritë mund të rezervohen nga dhënia e informacioneve për median dhe publikun bazuar në legjislacionin e Kosovës dhe standardet ndërkombëtare në rrethanat e mëposhtme, kur:

- 3.1. Informacioni do të vinte në rrezik një hetim apo ndjekje penale;
- 3.2. Informacioni do të dëmtonte integritetin, dinjitetin, sigurinë ose të drejtën për privatësi të kujtdo;
- 3.3. Informacioni që kërkohet është sekret zyrtar;
- 3.4. Informacioni do të zbulonte identitetin e një viktime;
- 3.5. Informacioni do të shkelte të drejtat e njeriut, dhe
- 3.6. Informacioni do të shkelte të drejtat e të miturve.

### **Neni 13**

#### **Mënyra e dhënies së informacionit**

Informacioni mund të shpërndalet në përputhje me këtë rregullore, në çfarëdo mënyre dhe duke mos u kufizuar në dokumente, regjistra, transkripte, urdhra, opinione, raporte, deklarata për shtyp, materiale të shtypura, fotografi, regjistrime në video dhe audio, llogaritje statistikore, modele, grafikë, diagrame dhe materiale të dhënash në çfarëdo formë elektronike.

### **Neni 14**

#### **Cilësia e informacionit**

KPK dhe PSH do të japin për publikun informacione në kohë të arsyshme, objektive dhe të sakta.

### **Neni 15**

#### **Procedurat e brendshme për koordinim me publikun**

1. Për ta bërë komunikimin e lehtë dhe efektiv me publikun, të gjithë zyrtarët për komunikim janë të detyruar të sigurojnë si më poshtë:
  - 1.1. Zyrtarët për Komunikim Publik dhe zyrtarët për media të prokurorive duhet të informohen menjëherë për të gjitha kërkesat nga media për intervista, artikuj të hollësishëm dhe/ose çështje që kanë të bëjnë për tërë sistemin prokurorial të Kosovës, pastaj në koordinim me prokurorin e çështjes dhe Kryeprokurorin përkatës jep përgjigje.
  - 1.2. Të gjithë përfaqësuesit nga media do të trajtohen njëjtë, me mirësjellje profesionale dhe me konsideratë për afatet dhe kufizimet që kanë mediat.
  - 1.3. Nuk do të bëhet asnjë koment publik apo të përhapet ndonjë informacion që ka të bëjë me një çështje të caktuar, pa u koordinuar me zyrtarin kompetent për atë çështje.

- 1.4. Nuk do të bëhet asnjë koment publik apo përhapet ndonjë informacion që ka të bëjë me çështje thelbësore në cilëndo Prokurori ose që ka lidhje me ndonjë hetim të hapur apo ndjekje, pa marrë më parë miratimin e shprehur të prokurorit të çështjes.
- 1.5. Përpara caktimit të konferencave për shtyp nga ndonje zyrtar i sistemit prokurorial të Kosovës, duhet paraprakisht që ai të koordinohet me personat përgjegjës.
- 1.6. Lajmet dhe artikujt e ndryshem në media, të cilat kanë të bëjnë me informacione për tërë sistemin prokurorial, apo edhe ku është i lakuar emri i ndonjë zyrtari që punon në sistemin prokurorial, duhet të kalohen sa më shpejt të jetë e mundur tek personat kompetent, që mund të jenë zyrtaret e përfshirë në rast nga sistemi prokurorial, kryeprokurori i prokurorisë përkatëse, zyrtarit kompetent apo Zyres për Komunikim Publik.
- 1.7. Personat kontaktues me media mund të mos u përgjigjen kërkesave nga mediat që kanë të bëjnë me ndonjë rast, nëse ekziston rreziku se shpërndarja e këtij informacioni do të rrezikonte ndërhyrjen në ndjekjen apo dënimin e kryesit të një vepre penale apo do të rrezikonte jetën e kujtdo apo do të shkelte të drejtat e të dyshuarit për një hetim të fshehte, përveç kur për një çështje të tillë është vendosur ndryshe.
- 1.8. Për rastet që kanë arritur publicitet të konsiderueshëm, ose për të cilat publiku duhet të sigurohet se autoritetet e duhura po e hetojnë incidentin, ose kur dhënia e informacionit është e nevojshme për të mbrojtur interesin apo mirëqenien e publikut, mund të bëhen komente nga KPK dhe PSH. Në këto rrethana të jashtëzakonshme, zyrtarët për komunikim me publikun këshillohen nga kryeprokurori i prokurorisë përkatëse para se të shpërndajë informacionin për media.

#### **Neni 16** **Përgjegjësia disiplinore**

Mos respektimi i rregullores, mund të jetë baze për fillimin e procedurës disiplinore nëse e njëjta nuk përbën vepër penale.

**Neni 17**  
**Faqet zyrtare të internetit**

Faqet zyrtare të internetit të KPK-së dhe ZKPSH-së ofrojnë qasje në informacione që kanë të bëjnë me këto dy institucione, prokuroritë dhe me tërë sistemin prokurorial të Kosovës në tërësi. Deklaratat për shtyp, raportet vjetore, planet e punës dhe informacionet tjera të përditësuara që janë në interes të qytetarëve dhe mediave mund të sigurohen në adresat: [www.kpk-rks.org](http://www.kpk-rks.org) dhe [www.psh-ks.net](http://www.psh-ks.net)

**Neni 18**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hynë në fuqi pas miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Prishtinë, më 27 maj 2016

Blerim Isufaj   
  
Kryesues  
Këshilli Prokurorial i Kosovës